



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

TERMAT E REFERENCËS PËR PROJEKTIN
“REGJISTRI I FERMERËVE TË BASHKISË TIRANË”



Tabela e përmbajtjes

1. Përmbledhje.....	2
2. Përshkrimi i Detyrave dhe Përgjegjësi.....	4
3. Dorëzimet.....	4
4. Marrëveshjet e menaxhimit.....	5
5. Kohëzgjatja.....	5

Indeksi i Tabelave

Tabela Nr.1: Shpërndarja e popullsisë sipas Njësive Administrative rurale të Bashkisë Tiranë për vitin 2017: : : : :	3
--	---

Tabela Nr.2: Shërbimet e specifikuar që pritet të ofroj operatori: : : : :	
--	--



Indeksi i Grafikëve

Grafiku nr.1: Grafiku i ekzekutimit të shërbimeve.....	6
--	---

Shkurtime

DPSPZHE	Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik
DZHER	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural
Nj.A.	Njësi Administrative
UNDP	United Nation Development Program

1. Përmbledhje

Bashkia Tiranë ka 119253 familje ndër të cilat 30511 ndodhen në 13 Njësitë Administrative Rurale të saj (Petrelë, Farkë, Dajt, Zall-Bastar, Bërzhitë, Krrabë, Baldushk, Shëngjergj, Vazar, Kashar, Pezë, Ndroq, Zall-Herr), të ndara përkatësisht në tabelën si më poshtë:

Njësitë Administrative	Popullsia 2015	
	Gjithsej	Nr. Familjeve
Njësia Administrative Baldushk	5,356	1,356
Njësia Administrative Bërzhitë	5,861	1,573
Njësia Administrative Dajt	15,195	3,915
Njësia Administrative Farkë	13,259	3,322
Njësia Administrative Kashar	25,034	6,451
Njësia Administrative Ndroq	9,210	2,218
Njësia Administrative Petrelë	6,577	1,665
Njësia Administrative Pezë	5,823	1,439
Njësia Administrative Shëngjergj	2,728	869
Njësia Administrative Vaqarr	10,018	2,348
Njësia Administrative Zall Bastar	5,546	1,562
Njësia Administrative Zall Herr	11,548	2,906
Njësia Administrative Krrabë	3,098	887
TOTAL	119253	30511

Tabela Nr.1: Shpërndarja e popullsisë sipas Njësi Administrative rurale të Bashkisë Tiranë për vitin 2015

Projekti “Regjistri i Fermerëve të Bashkisë Tiranë” ka në fokus identifikimin dhe regjistrimin e fermerëve, të formalizuar ose jo, që jetojnë pranë Njësi Administrative rurale përkatëse. Projekti do të shtrihet në 12 Njësi Administrative Rurale (29155 familje) për një periudhë kohore prej 16 muajsh, duke mos përfshirë vetëm Nj.A. Baldushk, në të cilën është realizuar një regjistër fermeri gjatë periudhës shkurt-mars 2018, në kuadër të “*Paktit Territorial të Punësimit*”, pjesë e projektit “*Promovimi i zgjidhjeve gjithëpërfshirëse të tregut të punës në Ballkanin Perëndimor*”, i bashkëfinancuar me UNDP.

Fokusi në këtë regjistër fermeri do të jetë informacioni në lidhje me bujqësinë, blegtorinë, agro-përpunimin si dhe fushat e tjera të cilat ndikojnë në ekonominë familjare të çdo fermeri.

Nevoja për krijimin e një regjistri fermeri lind për arsye të sigurimit të të dhënave mbi burimet dhe asetet e territorit rural të Bashkisë Tiranë. Ky vërtetim do të lehtësojë orientimin e investimeve vendore, qëndrore apo edhe ato të huaja drejt fushave apo sektorëve më me potencial për zhvillim të mëtejshëm sipas zonave.

Objektivi i këtij projekti është grumbullimi i informacioneve të detajuara për secilin fermer, në formën e një censusi me të dhëna mbi:

- a) fermerët / familjet fermere;
- b) sipërfaqen e tokës bujqësore si dhe aktivitetin që zhvillohet në to;
- c) blegtorinë dhe tendecën e fermave blegtorale;
- d) shpendët dhe bletarinë;
- e) sistemin ujitës dhe mekanizimin e tokave bujqësore;
- f) industrinë përpunuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- g) të tjera.

Pas përfundimit të vrojtimit në terren, raporti teknik do të shërbejë për planifikimin dhe hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit rural në Bashkinë e Tiranës.

Në vijim, regjistri i fermerëve të Bashkisë Tiranë do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga organet përkatëse, të cilat me ligj kanë të përcaktuar në kompetencat e tyre funksione të lidhura me bujqësinë e blegtorinë.

Për implementimin e projektit “Regjistri i fermerëve të Bashkisë Tiranë” do të kontraktohet një Operator i cili do t’i nënshtrohet procedurave të Prokurimit Publik sipas Ligjit nr. 9643 datë 20/11/2006 për “Prokurimin Publik”, (i ndryshuar).

2. Përshkrimi i Detyrave dhe Përgjegjësi

Operatori pritet të ofrojë ekspertizë teknike për hartimin e metodologjisë (për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave) dhe instrumentet që vijnë në ndihmë të implementimit të projektit. Fillimisht do të nisët me një periudhë pilotimi 1-javore, në të cilën do të mund të verifikohet përshtatshmëria e pyetësorit dhe realizimi i ndryshimeve në rast nevojë për të arritur në grumbullim të suksesshëm të të dhënave gjatë vrojtimit në terren.

Projekti do të shtrihet në Njësitë Administrative Petrelë, Farkë, Dajt, Zall-Bastar, Bërzhitë, Krrabë, Shëngjergj, Vaqarr, Kashar, Pezë, Ndroq dhe Zall-Herr. Duke qenë se synimi i këtij projekti është regjistrimi i fermerëve të Tiranës dhe mbledhja e të dhënave për aktivitetin e tyre bujqësor, projekti nuk do të bulojë zonat e urbanizuara brenda njësi administrative rurale. Kështu, në Njësitë Administrative Dajt, Kashar dhe Farkë, projekti do të shtrihet vetëm në zonat rurale, duke përjashtuar Lagjet nr. 12, nr. 13 dhe nr. 14, sipas kufijëve të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 33, datë 29.03.2018, “Për krijimin e tre Lagjeve në Qytetin e Tiranës”.

Në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Tiranës, kontraktori do të jetë përgjegjës për:

- Të hartojë metodologjinë për mbledhjen e të dhënave sipas pyetësorit bashkëlidhur;
- Të përcaktojë instrumentet për mbledhjen e të dhënave;
- Të hartojë formatin e raportimit;
- Të hartojë planin e punës në terren dhe të realizojë mbledhjen e të dhënave;
- Të monitorojë dhe kontrollojë procesin e grumbullimit të të dhënave;
- Të ofrojë një zgjidhje teknike për dizajnin dhe ngritjen e një baze të dhënash;
- Të hedhë të dhënat në një format statistikor të miratuar në bazën e të dhënave që do të ngrihet;
- Të hartojë dokumentimin e procesit të implementimit të projektit;
- Të përpilojë raportin final i bazuar në të dhënat e grumbulluara.

3. Dorëzimet

Operatori duhet të kryejë këto dorëzime:

- Metodologjia e mbledhjes së të dhënave;
- Manuali i trajnimit për koordinatorët që do realizojnë punën në terren;;
- Pyetësorët e plotësuar për të gjitha familjet e intervistuar;
- Baza e të dhënave në format elektronik i dizenuar për studim;
- Të dhënat e hedhura në formatin elektronik të bazës së të dhënave;
- Dokumentin përshkruës mbi procesin e realizimit të projektit;
- Raporti i analizës së të dhënave.

Bashkia Tiranë do të vendosë në dispozicion të operatorit dokumentat si më poshtë:

- Pyetësi i fermerit;
- Manuali i trajnimit të anketuesve

Operatori do të jetë përgjegjëse për shumfishimin e dokumentave të mësipërm sipas nevojës për realizimin e punës në terren.

4. Marrëveshjet e menaxhimit

Operatori do të jetë përgjegjës për menaxhimin e procesit të detyrave, burimeve njerëzore, logjistikës dhe shpenzimeve të lidhura me detyrat në aspektin kohor dhe përshtatshmërinë në konsultime të ngushta me Bashkinë e Tiranës. Procesi i përgjithshëm do të mbikëqyret nga DZHER/DPPSZHE. Raportimi dhe monitorimi i progresit të punës do të mbahet me operatorin në baza të rregullta.

5. Kohëzgjatja

Operatori pritet të ofrojë shërbimet e specifikuar nga nënshkrimi i kontratës dhe më tutje sipas periudhave kohore të shprehura si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Aktiviteti	Afati realizimit të aktivitetit
1.	Trajnimi	Trajnimi i anketuesve	16 MUAJ
2.		Hartimi i manualit të trajnimit të koordinatorëve	
3.		Trajnimi i koordinatorëve	
4.	Puna në terren	Realizimi i vrojtimit në terren	
5.	Baza e të dhënave	Dizenjimi i formatit elektronik i bazës së të dhënave	
6.		Hedhja e të dhënave në databazë	
7.	Përpunimi I të dhënave	Hedhja e të dhënave në një format të miratuar statistikor	
8.	Dokumentimi i procesit	Hartimi i relacionit mbi procedurat e ndjekura për implementimin e projektit	
9.	Raporti final	Hartimi i raportit final mbi bazën e të dhënave të grumbulluara	

Tabela Nr.2: Shërbimet e specifikuar që pritet të ofroj operatori

	MUAJ															
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	XIII	XIV	XV	XVI
Trajnimi																
Puna në terren																
Baza e të dhënave																
Përpunimi I të dhënave																
Dokumentimi i procesit																
Raporti final																

Grafiku nr.1: Grafiku i ekzekutimit të shërbimeve

